



JANAR 2023

BUJQËSIA 2022 PRIORITETET 2023

PREZANTOHET BILANCI I MINISTRISË SË BUJQËSISË PËR VITIN 2022

Bilanci i vitit 2022 u prezantua përpara fermerëve, blegtorëve, agropërpunuesve, peshkatarëve dhe medias. Një vit sfidues, por edhe një vit rezistence, force dhe përkushtimi të jashtëzakonshëm të njerëzve të punës në këtë sektor. Ministria e Bujqësisë është e vendosur për të çuar para politikat më të mira në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm rural, sigurisë ushqimore, peshkimit dhe objektivave tanë për 1 miliard dollarë eksporte në vitin 2030.



55.1 MLD LEKË EKSPORTE BUJQËSORE NË 2022

REKORD PËR PRODHIMIN SHQIPTAR

+18.1% NË VLERË DHE +15.6% NË SASI RRIJTJA E EKSPORTEVE KRAHASUAR ME 2021

MINISTRIA E BUJQËSISË MERR PJESË NË FORUMIN GLOBAL TË BUJQËSISË DHE AGRIKULTURËS (GFFA) NË BERLIN, GJERMANI



Forumi Global i Bujqësisë organizuar nën kujdesin e veçantë të Ministrit Gjerman Cem Özdemir mbledhi në Berlin më shumë se 70 ministra bujqësie, Komisionerin Evropian të bujqësisë, si dhe organizata ndërkombëtare, në një diskutim të gjerë për aktualitetin e politikave ushqimore dhe bujqësore.

Ministrja Krifca prezantoi qartësisht objektivin dhe mundësinë e Shqipërisë për zgjerimin e eksporteve bujqësore në volume dhe në tregje të reja, kërkoi dhe ofroi më shumë bashkëpunim në mekanizmat ndërkombëtarë, ndërkohë që marrim pjesë në përpjekjet e përbashkëta të vendeve që po përpiqen të menaxhojnë impaktin e luftës në Ukrainë dhe impaktin e ndryshimeve klimatike në bujqësi.

REALIZOHET CERTIFIKIMI I 4 PRODUKTEVE TË PARA TË ORIGJINËS SHQIPTARE



Përpara prodhuesve tanë prezantuan rezultatet e një pune të madhe për të identifikuar, regjistruar, mbrojtur në treg dhe ofruar tek konsumatori produktet e para të certifikuar për treguesit gjeografikë, emërtimin e origjinës dhe specialitetin tradicional të garantuar, duke rritur vlerën e tyre dhe fuqizuar prodhuesin shqiptar. Katër produktet e para, Djathi Mishavina i Bjeshkëve të Kelmendit, Mjalti i Bedunicës, Djathi i Ziem i Veleçikut dhe Djathi i Dhisë nga Bjeshkët e Rrunjës janë tashmë të mbrojtura dhe të certifikuar, me rrugën e hapur drejt tregut me ndikim qartësisht pozitiv në zhvillimin rural.

MINISTRJA KRIFCA MIRËPRET DREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË SË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR USHQIMIN DHE BUJQËSINË (FAO), Z. QU DONGYU.



U realizua një agjendë intensive takimesh në Shqipëri me Z. Qu Dongyu, Drejtor i FAO-s, gjatë të cilave u diskutua gjerësisht mbi rritjen e aksesit të bujqësisë shqiptare ndërkombëtarisht, thellimin e bashkëpunimit me FAO-n, si dhe mbështetjen e kësaj organizate të rëndësishme botërore për vazhdimin e politikave tona të orientuara drejt zgjerimit të tregjeve dhe rritjes së eksporteve bujqësore shqiptare.

MINISTRJA KRIFCA PREZANTON PROJEKTLIGJIN PËR SEKTORIN E BLETARISË



U prezantua sot para Komisionit të Vepërimitarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, Projektligji Për Bletarinë, i cili rregullon dhe njeh rolin e veçantë të bletës dhe bletarisë në mjedis, bujqësi, ekonomi dhe krijimin e të ardhurave për ekonomitë rurale duke i dhënë një rol themelor e duke nxitur zhvillimin e mëtejshëm të bletarisë.

SEKTORI I VERËS NË SHQIPËRI NË VËMENDJEN E REVISTËS PRESTIGJIOZE DECANTER



Gazetari i mirënjohur Darrel Joseph ka dhënë një pasqyrë kuptimplote të zhvillimit të vreshtarisë dhe verëtarisë në vend, çka ai konstatoi vetë gjatë vizitës në territor në nëntor, e të cilën e ka pasqyruar në faqet e prestigjiozes botërore "Decanter". Vëmendja e "Decanter" është një tjetër sukses ndërkombëtar për këtë industri me potencial të jashtëzakonshëm për ekonominë rurale në vendin tonë.

ZHVILLUAM DISKUTIMIN E PËRBASHKËT ME MINISTREN IBRAHIMAJ DHE PËRFAQËSUES TË FERMAVE BLEGTORALE PËR HARTIMIN E POLITIKAVE TË SEKTORIT



Ministrja Frida Krifca së bashku me Ministren Delina Ibrahimaj dhe një përfaqësi të fermave blegtorale nga e gjithë Shqipëria, gjatë një tryeze të përbashkët diskutuan mbi ndikimin e politikave fiskale në blegtori dhe zinxhirin prodhues e përpunues, duke siguruar blegtorët për transparencë të këtyre politikave dhe për mbështetje të vazhdueshme të sektorit.